



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Albatrade Music&Movie L.L.C.
Numri unik identifikues - 811293993
Personi i autorizuar – Florend SHALA
OSHMA EKTRAN – DOK - UNIVERS
Rr/Kushtrim Jashari pn,
Prishtinë

Ref:1911/1378/LIC/ni

VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale “Ekran - DOK- UNIVERS”
për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 16 tetor 2019, kandidati “Ekran - DOK- UNIVERS”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.

Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “Ekran - DOK- UNIVERS”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së "Ekran - DOK- UNIVERS" ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së "Ekran - Dok- Univers", duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni konstaton se kandidati "Ekran - DOK - UNIVERS", ka parashtrua aplikacionin e tij në pajtim me Ligjin për KPM-ne, Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Meiale Audio dhe Audiovizuale (KPM – 2017/02) Rregulloren për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM - 017/06) dhe në pajtim me Formën e Aplikimit.
8. Komisioni vlerëson se, kandidati "Ekran - DOK- UNIVERS" ka përmbushur kriteret kualifikuese për t'u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, me përmbajtje tematike, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

Vendim

9. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 12 dhjetor 2019, merr vendim që, kandidatit Ekran - DOK- UNIVERS, me seli në Prishtinë, t'i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
10. OSHMA Ekran - DOK - UNIVERS, mund të fillojë veprimtarin si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA), për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës të KPM-së.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



datë